

VENDIM
Nr. 126/2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 100/2017 “PËR
CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 21/1, 55, pikat 2 dhe 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partive të Djathta,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 100/2017 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Deputeti Zef Shtjefni caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

2. Deputeti Koçi Tahiri caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Politikën e Jashtme.

3. Deputeti Selami Jenishehri caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

4. Deputeti Ervis Meço caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Integrimin European dhe në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 17.10.2019